



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Kosova Cumhuriyeti**



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren**  
**Prizren Belediyesi**

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), Rregulloren me nr. 001/011-201 të datës 28.12.2023, vendimin nr. 138/25 të datës 20.02.2025, vendimin nr. 137/25 të datës 20.02.2025, Komuna e Prizrenit, shpall:

**Nr. 371/2025**

**Datë 28.02.2025**

**KONKURS**  
**PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR**  
**VITIN AKADEMIK 2024/25**

<b>I. FAKULTETI FILOZOFIK</b>		
1	Dega e punës sociale	3
2	Socjologji	3
3	Psikologji	3
4	Filozofi	2
5	Histori	6
6	Antropologji	2
7	Shkencat Politike	2
	<b>TOTALI</b>	<b>21</b>
<b>II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE</b>		
1	Biologji	5
2	Ekologji dhe mbrojtja e ambientit	2
3	Fizikë	5
4	Kimi	5
5	Matematikë	5
6	Matematik financiare	3
7	Gjeografi	5
8	Shkencat kompjuterike	5
	<b>TOTALI</b>	<b>35</b>
<b>III. FAKULTETI I FILOLOGJISË</b>		
1	Gjuhës dhe Letërsisë Angleze	5
2	Gjuhës Shqipe	5
3	Letërsi Shqipe	4
4	Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane	5
5	Gjuhës Boshnjake	2
6	Gjuhës Turke	2
7	Gjuhë Frënge	2
	<b>TOTALI</b>	<b>25</b>

<b>IV.</b>	<b>FAKULTETI JURIDIK</b>	
1	Drejtimi i përgjithshëm	10
	<b>TOTALI</b>	<b>10</b>
<b>V.</b>	<b>FAKULTETI EKONOMIK</b>	
1	Departamenti Banka, Financa	2
2	Departamenti Menaxhment	2
3	Departamenti i Marketingut	2
4	Administrim Biznesi	2
5	Ekonomiks	2
6	Menaxhment	2
7	Menaxhment Ndërkombëtar	2
	<b>TOTALI</b>	<b>14</b>
<b>VI.</b>	<b>FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS</b>	
1	Drejtimi i Konstruktiv	4
2	Drejtimi i Hidroteknikës	2
3	Drejtimi inxhinieri e ambientit	2
4	Drejtimi i Gjeodezisë	3
5	Arkitekturës	4
6	Efiqienca e energjisë	2
	<b>TOALI</b>	<b>17</b>
<b>VII.</b>	<b>Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike</b>	
1	Departamenti i Telekomunikacionit	2
2	Departamenti i Elektronik	2
3	Departamenti i Automatikë dhe robotikë	2
4	Departamenti i Sistemeve Elektroenergjetike	2
5	Inxhinieri kompjuterike dhe softuerike	2
	<b>TOALI</b>	<b>10</b>
<b>VIII.</b>	<b>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike</b>	
1	Termoenergjetikë dhe Energji të Ripërtëritshme	2
2	Dizajn inxhinierik dhe Automjete	2
3	Komunikacion dhe transport	2
4	Mekatronikë	2
5	Prodhimtari dhe Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti	2
	<b>TOTALI</b>	<b>10</b>
<b>IX.</b>	<b>FAKULTETI I MJEKËSISË</b>	
1	Dega e Mjekësisë së përgjithshme	15
2	Dega e Stomatologjisë	8
3	Dega e Farmacisë	8
5	Dega e Fizioterapi	5
6	Infermieri	8
	<b>TOTALI</b>	<b>44</b>
<b>X.</b>	<b>FAKULTETI I ARTEVE</b>	
1	Dega: art figurative, dramatik, muzikor etj.	8
	<b>TOTALI</b>	<b>8</b>

<b>XI.</b>	<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë për të gjitha drejtimet</b>	<b>5</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>5</b>
<b>XII.</b>	<b>FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIKË DHE I SPORTIT</b>	<b>8</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>8</b>
<b>XIII.</b>	<b>FAKULTETI I EDUKIMIT</b>	
1	Pedagogji e përgjithshme	3
2	Programi fillor	5
3	Parashkollor	5
4	Programi fillor mësimi në gjuhën Turke	3
5	Programi parashkollor mësimi në gjuhën Turke	2
6	Programi fillor mësimi në gjuhën Boshnjake	3
7	Programi parashkollor mësimi në gjuhën Boshnjake	2
	<b>TOTALI</b>	<b>23</b>
<b>XIV.</b>	<b>FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE</b>	
1	Dizajnimi i Softverëve	5
2	Teknologji e Informimit dhe Telekomunikimit	5
	<b>TOTAL</b>	<b>10</b>
<b>XV.</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit</b>	
1	Agrobiznes	4
2	Shkencat e pyjeve dhe mjedisi	4
	<b>TOTAL</b>	<b>8</b>
1	<b>Student nga komuniteti RAE</b>	<b>2</b>
	<b>TOTAL</b>	<b>2</b>
	<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM:</b>	<b>250</b>

### Kushtet:

Studentët e interesuar për konkurrim duhet të parashtrojnë këto dokumente:

1. Aplikacionin i cili merret në faqe të Komunës së Prizrenit,
2. Kopjen e letërnjoftimit, Certifikata/ekstrakti i lindjes, kopjen e ID-së së studentit.
3. Certifikatën e vitit të regjistrimit akademik 2024-2025, duke e cekur:
  - a) se është student i vitit të dytë, tretë, katërtë e pestë...
  - b) notën mesatare gjatë studimeve të vërtetuar nga fakulteti
  - c) se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve
- ç) certifikatën e provimeve të dhëna me datat e dhënies së provimeve.
4. Vërtetimin se është fëmijë i dëshmorit, invalidit dhe veteranit të luftës së UÇK-së, i cili dokument merret në shoqatat e dalura nga lufta.
5. Dëshminë se kandidati merr ndihmë sociale të konfirmuar me dokument nga Qendra për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Prizren (kjo vlen vetëm për ata kandidatë, që familja e tyre e gëzojnë të drejtën e asistencës sociale).
- 5.1 Studentët nga komuniteti RAE duhet të dëshmojnë me vërtetim se janë nga ky komunitet dhe drejtimet për këtë komunitet nuk janë të përcaktuara sipas konkursit.
6. Të drejtë konkurrimi për realizimin e bursës kanë studentët - kandidatë që janë banorë të Komunës së Prizrenit dhe të konfirmohet me certifikatën e vendbanimit, të ketë notë mesatare mbi **7.5**, të cilët kanë fituar të drejtën e regjistrimit të vitit: II-III-IV-V- në vitin akademik 2024/2025 në Universitetet Publike të Republikës së Kosovës dhe studentë jashtë shtetit në Universitetet Publike. Studentët jashtë shtetit në Universitete Publike janë të obliguar të bëjnë konvertimin e notës mesatare sipas pikës 15 të këtij konkursi.

7. Aplikacioni merret në web faqe të komunë ose në sportelin në objektin e administratës dhe i plotësuar, dorëzohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek adresa jonë: në sportelin e pranimit në objektin e administratës komunale në Komunën e Prizrenit, rr. "Remzi Ademaj" pn. - Prizren, çdo ditë pune prej orës 09:00 deri 15:00. **Afati për aplikim fillon nga data 04.03.2025 e deri më 24.03.2025**
8. Kriteri i notës mesatare 7.5 nuk vlejnë për studentët (fëmijë të dëshmorëve, invalidëve, dhe veteranëve të UÇK-së si dhe rastet e ndihmave sociale) ku të njëjtit kanë të drejt të aplikojnë edhe me notë mesatare më të ultë se **7.5** por ju shtohen edhe nga 10 pikë.
9. Bursa ndahen vetëm për studentë e studimeve bazë e jo edhe për master.
10. Pas mbylljes së afatit të aplikimit, komisioni shqyrton dokumentacionin dhe bën listën Përfundimtare.
11. Studentët që nuk i kanë prindërit në jetë (të dëshmohet) në kushte të barabarta ka përparësi
12. Studentët me nevoja të veçanta (të dëshmohet) në kushte të barabarta ka përparësi
13. Kandidatëve të cilëve ju ndahet bursa, për kushtet e shfrytëzimit të sajë do të nënshkruajnë kontratë të veçantë, ku do të precizohet kushtet, obligimet dhe detyrat e dyanshme.
14. Renditja e kandidatëve në listë bëhet në bazë të këtyre kritereve:
  - a) Suksesi në studime: 50 pikë të mundshme.
  - b) Studentët e vitit: III, IV, V dhe VI marrin nga 2 pikë shtesë për çdo vit.
15. Për suksesin e studimeve kandidati fiton këto pikë:
  - a) për notën mesatare 10 (dhjetë) : 50 pikë
  - b) 9 (nëntë) : 40 pikë
  - c) 8 (tetë) : 30 pikë
  - d) 7.5 (shtatë pikë pesë) : 25 pikë
  - e) Psh. Për notën mesatare 8.4 kandidati fiton 34 pikë, 8.8 kandidati fiton 38 pikë ose për notën mesatare 9.4 kandidati fiton 44 pikë, për notën 9.8 kandidati fiton 48 pikë.
16. Në rast kur në një profil të caktuar nuk ka aplikues/përfitues të bursës, atëher komisioni i vlerësimit ka të drejtë rialokim të bursave në profilet me prioritet.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

## APLIKACION

Për shfrytëzimin e bursës për studentë për vitin akademik – 2024/2025

Në bazë të konkursit për ndarjen e bursave për studentë të shpallur nga Komuna e Prizrenit, konkurrojnë për bursë Komunale dhe ofroj këto të dhëna:

1.	<b>Emri, emri i prindit dhe mbiemri</b>	
2.	<b>Data e lindjes</b>	
3.	<b>Vendi i lindjes</b>	
4.	<b>Komuna</b>	
5.	<b>Shteti</b>	
6.	<b>Vendbanimi</b>	
7.	<b>Adresa (rruga dhe numri)</b>	
8.	<b>Nr. i telefonit</b>	
9.	<b>Email adresa</b>	
10.	<b>Fakulteti</b>	
11.	<b>Drejtimi</b>	
12.	<b>Numri i indeksit</b>	
13.	<b>Viti i regjistrimit në fakultet për herë të parë</b>	
14.	<b>Viti i studimeve</b>	<b>I, II, III, IV, V, VI, (rretho)</b>
15.	<b>Kam regjistruar semestrin:</b>	
16.	<b>Nota mesatare gjate studimeve</b>	
17.	<b>Fëmijë i dëshmorit, invalidit, veteranit të luftës (PO ose JO)</b>	
18.	<b>Jam përfitues i ndihmave sociale (PO ose JO)</b>	
19.	<b>A keni vit të përsëritur (PO ose JO)</b>	

Jam në dijeni se për çdo pa korrektësi në plotësimin e këtij aplikacioni, apo të cilido dokument tjetër që kërkohet me konkurs, komisioni për ndarjen e bursave rezervon të drejtën që të më përjashtojë nga konkurrenca, apo të ma ndërpresë kontratën në mënyrë të njëanshme dhe të iniciojë procedurë të rregullt ligjore për kthimin e bursës. Nota mesatare të shënohet e saktë në të kundërtën studentit nuk do t'i nënshkruhet kontrata për përfitimin e bursës.

Datë \_\_\_\_\_